




STORJET E SUKSESIT

NGA LIDERËT E SË NESËRMES



Prishtinë
Shkurt, 2018

STORJET E SUKSESIT

NGA LIDERËT E SË NESËRMES

Prishtinë
Shkurt, 2018

Që nga viti 1999, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) në Kosovë ka mbështetur qytetarët dhe udhëheqësit politikë në gjitha nivelet, për të ndërtuar një kulturë të fortë qytetare duke krijuar institucione demokratike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. *Demokracia varet nga këto institucione - zëri i një qytetari të informuar - për të lidhur qytetarët me qeverinë e tyre dhe me njëri-tjetrin duke ofruar rrugët për pjesëmarrje në politikën publike.*

Qytetarët gëzojnë shumë përfitime dhe të drejta të garantuara në një demokraci, por shpesh nuk kuptojnë plotësisht përgjegjësitë e tyre si qytetarë për të mbrojtur dhe ushtruar ato të drejta. Ndër këto përgjegjësi janë veprimet e vetë organizimit, angazhimit, pjesëmarrjes dhe avokimit në proceset politike për të siguruar përfaqësim më të madh, përfshirje dhe drejtësi sociale. Këto parime janë të nevojshme për qytetarët për të kuptuar si detyrime për të arritur përfitimet e qëndrueshme të një sistemi demokratik. Nga ana tjetër, partitë politike duhet të jenë të organizuara dhe të gatshme për të vepruar si një mjet për të kanalizuar politikën tek institucionet qeveritare dhe të jenë proaktive në nxitjen e pjesëmarrjes më të madhe të qytetarëve në procesin politik, duke siguruar që politikatat të reflektojnë shqetësimet dhe interesat e tyre.

Në këtë broshurë, NDI është krenar të paraqetë arritjet e një grupi të shquar aktivistësh të grave dhe të rinjve, të cilët kanë marrë përsipër përgjegjësitë e tyre qytetare, duke ndihmuar në ngritjen e shqetësimeve të qytetarëve brenda partive të tyre politike dhe vendim - marrësve të tjerë, për të sjellë ndryshime në komunitetet e tyre. Që nga viti 2013, NDI ka ofruar trajnime për ngritjen e aftësive në angazhimin efektiv politik dhe avokimin, për këta individë nga komunitetet serb folëse përmes Akademisë Politike të Grave (APG) dhe Programit për të rinjtë në leadership (PRL), me fonde nga Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përtej trajnimeve, programet u ofruan këtyre udhëheqësve në zhvillim të komunitetit mundësi të rrjetëzimit dhe të bashkëpunimit me njëra-tjetrën, në të gjithë pikat partiake, gjeografike dhe etnike, duke mësuar rreth shqetësimeve të përbashkëta dhe duke zhvilluar strategji të përbashkëta për t'iu qasur atyre.

Duke synuar gratë dhe të rinjtë nga komunitetet serbe të cilët vijnë kryesisht nga Veriu, NDI kërkon të promovojë angazhimin e serbëve në procesin politik dhe të mbështesë përfshirje më të madhe të komuniteteve në institucionet e Kosovës. Nëpërmjet APG, gratë nga të gjitha sferat e jetës dhe partitë politike në të gjithë spektrin politik, kanë dedikuar kohën e tyre për të mësuar zhvillimin e politikave, të folurit në publik, avokimin, menaxhimin e kohës dhe aftësitë e komunikimit. Nëpërmjet PRL, aktivistët e rinj nga partitë politike dhe shoqëria civile mësuan se si të zhvillojnë fushata politike dhe të avokimit, duke u fokusuar në zhvillimin e mesazheve, hulumtimet dhe aktiviteteve efektive në terren. Përveç trajnimeve të strukturuar, të dy grupet morën mentorim të rregullt nga stafi i NDI-së dhe ekspertët ndërkombëtarë për t'i mundësuar të gjithë pjesëmarrësve që të praktikojnë gjithçka që kanë mësuar.

Iniciativat e publikuara në këtë broshurë janë rezultat i angazhimit të madh të këtyre udhëheqësve në zhvillim, punës së madhe dhe gatishmërisë për të mbështetur komunitetet e tyre dhe për të marrë pjesë në përcaktimin e së ardhmes së Kosovës. Çështjet e trajtuara nga këto iniciativa janë motivuar nga nevojat dhe interesat e komunitetit dhe rezultatet e paraqitura këtu përfaqësojnë fitoret e tyre të para në atë që shpresojmë se është vetëm fillimi i aktiviteteve të këtyre udhëheqësve. Ato u bënë të mundura me mbështetjen e USAID-it dhe përpjekjet e palodhura të stafit të NDI-së që këto iniciativa dhe liderët e rinj të arrijnë suksese.

Këto gra dhe të rinj janë një frymëzim për të gjithë. Ata na tregojnë një Kosovë të re, ku nuk ka rëndësi se kush jeni ose çfarë bëni, ne mund të punojmë së bashku për të mirën e të gjithëve. Ata dëshmojnë se njerëzit - të çdo moshe, gjinie apo etnie - mund të bëjnë ndryshime dhe keto ndryshime, edhe nëse janë të vogëla, janë të mundura kur ekziston dëshira e fortë nga komuniteti dhe vullneti nga vendim - marrësit për ta realizuar atë. Shpresojmë që ju të shijoni leximin e këtyre iniciativave po aq sa NDI, duke përkrahur këta individë të mahnitshëm dhe shpresoj që shembujt e tyre të shërbejnë si frymëzim për të tjerët për të ndërmarrë hapin e parë për të bërë ndryshime në Kosovë.

Alexander Chavarria
Drjetor i
Institutit Demokratik Kombëtar-Kosovë

Në gati një dekadë që nga shpallja e pavarësisë, Kosova ka arritur progres të rëndësishëm në konsolidimin e institucioneve demokratike dhe proceseve politike të bazuara në vlerat dhe parimet demokratike. Partitë politike kanë filluar të zhvillojnë politika që janë më të përgjegjshme ndaj prioriteteve të qytetarëve; proceset zgjedhore po bëhen më transparente dhe më pak të pambrojtura ndaj parregullsive; Kuvendi po përforcon kapacitetet e tij për të miratuar legjislacionin cilësor dhe për të ushtruar mbikëqyrje më të madhe të ekzekutivit; dhe organizatat e shoqërisë civile po bëhen më efektive në artikullimin e nevojave të qytetarëve dhe në ndërtimin e iniciativave të shëndosha avokuese.

Instituti Kombëtar Demokratik për Çështjet Ndërkombëtare, një organizatë jofitimprurëse, jopartiake dhe joqeveritare e angazhuar në fuqizimin dhe avancimin e demokracisë në mbarë botën, ka qenë e pranishme në Kosovë që nga viti 1999. Me mbështetjen e Agjensionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), NDI ka punuar me Qytetarët e Kosovës çdo hap të rrugës pasi kanë ndërtuar demokracinë e tyre nga baza, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e partive politike dhe në demokratizimin e brendshëm; monitorimin e zgjedhjeve dhe pjesëmarrjen e qytetarëve; ndërtimin dhe forcimin e institucioneve efektive, transparente dhe të përgjegjshme; dhe avancimin e kapaciteteve të monitorimit dhe avokimit të organizatave të shoqërisë civile. NDI gjithashtu punon për të hapur rrugët për dialog ndër-etnik për të lehtësuar përpjekjet e drejtuara drejt transformimit të konflikteve dhe pajtimit të përhershëm etnik.

Aktualisht, NDI po zbaton një program për një qeveri llogaridhënëse në Kosovë, i financuar nga USAID, me qëllim të përmirësimit të reagimit legjislativ dhe politik ndaj nevojave të qytetarëve. Një mënyrë që Instituti po punon për ta arritur këtë është duke nxitur pjesëmarrjen kuptimplotë të grupeve e nënperfaqësuar në politikë si aktivistë të komunitetit, anëtarë të partive politike dhe përfaqësues të zgjedhur.

NDI beson se demokracia e Kosovës do të forcohet kur aktivistët qytetarë dhe politikë, veçanërisht gratë, të rinjtë dhe pakicat, janë fuqizuar për të identifikuar, zhvilluar dhe siguruar zbatimin e fushatave avokuese të bazuar në çështje; për të transformuar iniciativat e avokimit në politika efektive; dhe për të rritur presionin mbi legjislaturat për të mbajtur ekzekutivin llogaridhënës në nivel lokal dhe qendror.

Si pjesë e mbështetjes së saj ndaj partive politike, NDI ka punuar me lidërshpin e partive për të nxitur demokracinë e brendshme, me një fokus të veçantë në hapjen e hapësirës më të madhe për gratë dhe të rinjtë për të marrë role udhëheqëse dhe për të investuar në ngritjen e kapaciteteve të tyre. Akademia Politike e Grave të NDI-së dhe Programi për të rinjtë në lidërshpin, janë dy shembuj që ilustrojnë qasjen metodologjike të NDI-së për të bërë bashkë gratë dhe të rinjtë e gjitha partive politike, në këtë rast të veçantë ata nga komuniteti serb në Kosovë, për të mësuar aftësitë dhe teknikat e reja që rrisin aftësitë e tyre dhe t'i kthejnë ato në burime të vlefshme për partitë e tyre përkatëse. Duke punuar për të fuqizuar lidërshpin e ri dhe për të vendosur lidhje me përfaqësuesit politikë, NDI mund të inkurajojë udhëheqjen qendrore dhe të degëve të jenë përfshirëse ndaj atyre individëve që dalin nga baza dhe të sigurojnë që ata janë plotësisht të angazhuar në proceset politike.

IMPLEMENTIMI I LIGJIT PËR BARAZI GJINORE NË NIVEL LOKAL

Tri vite pas krijimit të komunave në veri të Kosovës, këto komuna vazhdojnë të përballen me sfida në aspekt të themelimit të mekanizmave institucionale dhe departamenteve përkatëse. Situata aktuale nuk është përmirësuar kryesisht për shkak të mungesës së dukshme të kapaciteteve të sistemit të qeverisjes lokale, mungesës së përkrahjes nga niveli qendror dhe mungesës së vullnetit politik. Komunitetet e veriut të Kosovës ende nuk kanë Zyra për Çështje Gjinore dhe zyrtarë përkatës për çështje gjinore, megjithëse të njëjtat përbëjnë obligim që rrjedh nga Ligji për Barazi Gjinore (Ligji).

Një grup i pjesëmarrësve në APG nga Zveçani gjatë një seance trajnimit identifikoi mungesën e strategjive lokale për barazi gjinore dhe implementimin joadekuat të Ligjit për Barazi Gjinore në nivel lokal si probleme kryesore në këtë drejtim. Gjatë eksplorimit të kësaj çështjeje, grupi ka konsultuar intensivisht aktivistë politikë dhe të shoqërisë civile që kishin njohuri relevante për çështje gjinore. Të frymëzuar nga ideja që nisma e tyre mund t'i kontribuojë implementimit më të mirë të vetë Ligjit por edhe të punës në vazhdim të Komunitetit të Zveçanit ngritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve, ky grup vendosi të hartojë një dokument rekomandimesh për të adresuar këto çështje.

“Nëse duam të krijojmë një shoqëri që bazohet në parimin e barazisë, është me rëndësi që qeverisja lokale të marrë parasysh aspektin gjinor gjatë zhvillimit të strategjive për implementimin e aktiviteteve të saj në baza ditore,” – Bllagica Radovanović.

Të përballur me këtë detyrë sfiduese, ky grup ka qenë i përkushtuar që të fillojë të punojë në zgjidhjen e problemit, duke i angazhuar të gjithë aktorët relevantë për implementimin e Ligjit për Barazinë Gjinore. Para ngritjes së kësaj çështjeje para Kuvendit Komunal, pjesëmarrësit u takuan me Kryetarin e Komunitetit, i cili ka vlerësuar rëndësinë e iniciativës së këtij grupi dhe theksonte se rekomandimet që grupi planifikonte t'i hartojë duhet të shfrytëzohen si pikë nisme për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Kryetari i Komunitetit premtoi se do të fillojë së punuari në strategjinë lokale për barazi gjinore, por theksoi se si komunitet dhe Zveçani në këtë drejtim duhet ndihmuar dhe përkrahur nga autoritetet qendrore.

Pas takimit me kryetarin e komunitetit, grupi organizoi punëtori me anëtarë të kuvendit komunal për t'ua prezantuar ligjet e Kosovës dhe normat ndërkombëtare, rregulloret dhe deklaratat e ndryshme për barazinë gjinore. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e implementimit të Ligjit për Barazi Gjinore dhe domosdoshmërinë e themelimit të Zyrës për Barazi Gjinore, duke krahasuar Kosovën me vendet tjera të rajonit,



duke i motivuar anëtarët e kuvendeve komunale që të fillojnë me ndryshime nga komuna e vet. Për më tepër, grupi organizoi një sesion informues me këshilltarë lokalë, gjatë së cilës një ekspert i Ligjit për Barazi Gjinore paraqiti dobitë e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Për shumë prej anëtarëve të kuvendeve komunale, kjo ishte hera e parë që merren me këtë temë dhe kishin reagime tejet pozitive.

"Mungesa e mekanizmave lokal proaktiv dhe efektiv për barazi gjinore, përfshirë këtu dështimin për të integruar perspektiva gjinore në strategjitë kryesore dhe planet e veprimit në nivel lokal, paraqet faktorin kryesor që rezulton me veprime të ndara dhe të pakoordinuara drejt mundësimit të barazisë gjinore në komunitetet lokale të komunave të veriut të Kosovës. Për këtë arsye, ne kemi vendosur që të bëjmë përpjekje për të lëvizur nga pika zero këtë çështje," – Dubravka Nickovic.

Pas takimeve me Kryetarin e Komunës dhe anëtarë të Kuvendit Komunal, pjesëmarrësit e kuptuan se krijimi i një drejtorie të re do të ishte hap madhor për një komunë të re dhe mund të mos jetë i mundur në një të afërme të afërt. Megjithatë, ata ishin edhe më të përkushtuar që të finalizojnë dokumentin e tyre me rekomandime, për t'i ofruar komunës sugjerime të detajuara dhe specifike. Për të pas më shumë mbështetje në këtë përpjekje, ata krijuan një rrjet të aktivistëve politikë dhe të shoqërisë civile për çështje gjinore.

Kjo rezultoi në organizimin e një tryeze të rrumbullakët me të gjithë aktetë relevante, e cila i ndihmoi grupit në rafinimin fillestar të rekomandimeve të tyre. Bazuar në këtë diskutim, si dhe në përvojat e pjesëmarrësve të ndryshëm në këtë çështje, grupi hartoi dokumentin me rekomandime, në mesin e të cilave përfshihet edhe hartimi i dokumenteve strategjike dhe një plani të veprimit për arritjen e barazisë gjinore dhe avancimin e pozitës së grave në Zveçan. Ata gjithashtu rekomanduan ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë, në mënyrë që më shpejtë të lëvizet drejt implementimit të plotë të Ligjit.



"Ne besojmë fuqishëm se ky dokument mund të ndihmojë në implementimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe rrjedhimisht në promovimin e të drejtave njerëzore të grave," Dragana Milentijevic.

Ky dokument u paraqit në seancë të Kuvendit Komunal të Zveçanit, dhe u pranua si i tillë nga shumica e tyre. Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Kuvendit Komunal shprehën brengat e tyre lidhur me kohën që nevojitet për të krijuar mekanizmat institucionalë dhe departamentet përkatëse, por prematuan se do t'i rishqyrtojnë rekomandimet dhe do të angazhojnë disa prej pjesëtarëve të grupit në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike.

Pjesëmarrësit: Bojana Bojovic, Gordana Mladjovic, Dragana Milentijevic, Dubravka Nickovic, Zlatana Radenkovic, Blagica Radovanovic



Përmirësimi i strategjive lokale për barazinë gjinore dhe zbatimi i joadequat i Ligjit për Barazi Gjinore në nivel lokal



Grupi kërkoi sugjerime përmes konsultimeve intensive me këshilltarë komunal dhe aktivistë të shoqërisë civile të cilët kanë njohuri përkatëse për çështjet gjinore



Kryetari i Komunës e vlerësoi rëndësinë e iniciativës dhe i mori rekomandimet



U organizua një tryezë me aktetë të ndryshëm dhe rekomandimet janë prezentuar në Kuvendin Komunal



Pushteti lokal i miratoi rekomandimet dhe filloi me zbatimin

SIGURIA NË TRAFIK NË AFËRSI TË SHKOLLAVE

Gjatë angazhimit të tyre përmes Akademisë Politike të Grave (APG), një grup i grave aktive nga Mitrovica e Veriut kanë lansuar një iniciativë të përbashkët me qëllim të sjelljes së ndryshimeve pozitive për qytetin e tyre. Edhe pse komuna e Mitrovicës së Veriut ka bërë investime të mëdha për të përmirësuar dukshëm infrastrukturën në qendër të qytetit, bindje e përgjithshme është se jashtë saj janë bërë fare pak investime. Mungesa e investimeve infrastrukturore është në veçanti e dukshme në zonën ku ndodhen disa shkolla, kampusi i universitetit dhe disa objekte tjera arsimore.

Për shkak të infrastrukturës joadekuate, përfshirë shtigjet e pamjaftueshme për këmbësorë, kalimet e pashënjuara të këmbësorëve dhe mungesën e sinjaleve të trafikut që alarmojnë se në afërsi gjenden shkolla, fëmijët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve në trafik në baza ditore, gjë që bën që prindërit të kenë brengë lidhur me dërgimin e fëmijëve në shkollë pa qenë të shoqëruar nga të rriturit.

"Duke qenë nënë vetëushqyese, unë përballem me këtë frikë çdo ditë. Nuk mund ta dërgoj vajzën në shkollë çdo ditë dhe ndihem e pafuqishme kur e di se ajo është në rrezik. Për këtë arsye, kam vendosur të jem pjesë aktive e kësaj iniciative." – Allrijana Bektesheviq.

Një anketë e shpërndarë tek prindërit e nxënësve rezultoi me disa zgjidhje të mundshme për këtë situatë. Zgjidhjet e

propozuara përfshinin krijimin e një zone të këmbësorëve, blerjen dhe vendosjen e shenjave të trafikut, dhe vendosjen e patrullave policore para shkollave për ta rregulluar trafikun gjatë kohës së fillimit dhe mbarimit të mësimi. Grupi i ndau këto propozime me autoritetet lokale, duke kontaktuar edhe me Drejtorinë e Urbanizmit.

Duke qenë se zgjidhjet e propozuara binin nën kompetencat e disa institucioneve të ndryshme, grupi mbajti disa takime me aktetë relevante kyçë, siç janë Drejtori i Administratës Komunale të Mitrovicës së Veriut, Komandanti Rajonal i Policisë së Kosovës, drejtorët e shkollave dhe përfaqësuesit e Drejtorisë së Urbanizmit. Të gjithë aktetë përkrahën punën e grupit, rekomandimet e së cilit u pranuan shumë mirë. Gjatë një takimi me asistentin e kryetarit të komunës, grupi u informua se Kryetari i Komunës përkrahte këtë nismë dhe do të ndihmonte grupin në implementimin e saj.

Të nxitur nga informatat pozitive të pranuar nga zyra e Kryetarit të Komunës, grupi e paraqiti nismën e vet gjatë një dëgjimi publik të mbajtur më 21 shtator 2016, ndërsa e njëjta u miratua nga Kuvendi Komunal një ditë më vonë. Kuvendi komunal përfshiu në buxhetin komunal të vitit 2018 edhe kërkesën e grupit për të ndërtuar 'zona të sigurta' në afërsi të shkollave të caktuara.





"Falë bashkëpunimit me NDI dhe USAID, të cilat konsideruan se ishte koha e duhur për të filluar me edukimin dhe fuqizimin politik të grave nga veriu i Kosovës, ne kishim mundësi të veprojmë dhe të bëjmë diçka të dobishme për komunitetin tonë." – Olivera Milloseviq.

Për të përmbyllur punën e vet, grupi organizoi një tryezë të rrumbullakët me Zyrën e Administratës dhe me akterë relevantë, me qëllim të paraqitjes së rezultateve të nismës dhe avokimit tek autoritetet lokale për përkrahje të mëtejme për iniciativat e ardhme. Pas miratimit të iniciativës nga komuna, grupi lansoi fushatën e vet avokuese për t'i edukuar fëmijët sa i përket sigurisë në komunikacion, duke mbajtur punëtori me nxënës të klasës së parë të shkollës fillore Branko Radiçeviq. Anëtarët e grupit u shpërndanë nxënësve jelekë të sigurisë, si masë për t'i bërë fëmijët më të dukshëm për pjesëmarrësit e trafikut deri në ndërtimin e zonës së sigurisë.

"Me përkrahje të NDI dhe USAID, ne arritëm të lëvizim nga pika zero. Si grup joformal i grave aktive, ne kemi për qëllim të vazhdojmë të punojmë në iniciativa të ngjashme, por herën tjetër do të fokusohemi në tema më të ndjeshme," – Suada Hajdarpashiq.

Një patrullë e policisë gjithashtu u vendos para shkollës fillore Branko Radiçeviq, ndërsa zyra e Kryetarit të Komunës e njoftoi grupin se rekomandimet e tjera të tyre do të përfshihen në planin e infrastrukturës komunale për vitin 2018.

Pjesëmarrësit: Aldijana Bektesevic, Jasmina Dedic, Suada Hajdarpasic, Milena Jovanovic, Aleksandra Kostic, Olivera Milosevic, Sanela Muranovic, Dragica Paunovic, Vasiljka Vojinovic



Mbrojtja e fëmijëve që janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të trafikut në baza ditore dhe ndërtimi i një "zone të sigurt" në zonën ku gjinden disa shkolla, kampus universitar dhe institucione të tjera arsimore



Të gjeturat nga hulumtimi dhe rekomandimet janë prezentuar akterëve të ndryshëm të interesit



Iniciativa u mbështet nga Policia, Komuna dhe drejtorët e shkollave përmes tryezavë dhe takimeve intensive



Iniciativa dhe rekomandimet u prezentuan në assambleenë lokale dhe u miratua nga shumica e këshilltarëve komunal



Komuna i miratoi rekomandimet dhe ndërtoi "zonën e sigurtë"

DEKLARATA PËR BUXHETIMIN E PËRGJEGJËSHËM GJINOR

Barazia e grave dhe burrave përbën të drejtë fundamentale dhe vlerë esenciale për demokracinë e vendit dhe integrimin e tij në Bashkimin Evropian, por barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme në komunën e Zubin Potokut nuk është realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejtat e njëjta, sepse ka shumë pabarazi sociale, politike, ekonomike dhe kulturore. Edhe pse qytetarët si taksapagues dhe konsumatorë trajtohen në mënyrë të barabartë gjatë hartimit të buxhetit komunal, përvoja ka dëshmuar se qytetarët nuk marrin pjesë në mënyrë të barabartë në financimin apo shfrytëzimin e buxhetit. Përveç kësaj, marrë parasysh trendin në rritje të grave që largohen nga komuna drejt zonave ku kanë qasje më të mirë në burime financiare, grupi i APG nga Zubin Potoku ishte i motivuar për t'i bërë akterët përgjegjës që të kuptojnë më mirë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe t'u ndihmojnë atyre në implementimin e saj.

"Kjo ide rridhte nga fakti se ne njohim shumë gra që kanë potencial për të udhëhequr biznese private, por për shkak të qasjes së kufizuar në burime financiare, ato u larguan nga komuna duke kërkuar një të ardhme më të mirë për familjet e tyre," – Millica Rakiq.

Përmes takimeve me zyrtarë komunalë, grupi grumbulloi informata lidhur me shpenzimet buxhetore mes viteve 2014

dhe 2015, duke analizuar vlerën, ndikimin dhe qëllimin e projekteve kundrejt nevojave të komunitetit. Marrë parasysh kompleksitetin e kësaj detyre, grupi angazhoi një ekspert të barazisë gjinore për t'i ndihmuar në hartimin e një analize të detajuar mbi ndikimin e projekteve qeveritare mbi të dy gjinitë dhe për të formuluar rekomandimet lidhur me planifikimin buxhetor në të ardhmen, përfshirë ofrimin e sugjerimeve konkrete për projekte specifike që duhet financuar.

"Ne e kemi ditur çka duam, por pasi që asnjëra prej nesh nuk kishte njohuri apo ekspertizë relevante mbi këtë temë, ne vendosëm të angazhojmë një ekspert për të na ndihmuar në analizimin dhe përkrahjen e aktiviteteve të ardhme. Ne deshëm të kemi një qasje serioze pasi që kjo çështje është shumë e rëndësishme, ndërsa asnjë nga komunat e veriut për momentin nuk i është qasur buxhetimit të përgjegjshëm gjinor." – Natasha Trifunović

Analiza tregoi se programet përkrahëse për ndërmarrëse, studente dhe përfituese të shërbimeve sociale vazhdojnë të ofrohen kryesisht nga organizatat joqeveritare e jo nga komunat. Grupi dhe eksperti përcaktuan dy mënyra kritike për të avancuar buxhetimin e ndjeshëm gjinor në komunë. Mënyra e parë është që të ngriten kapacitetet e zyrtarëve komunalë



të Drejtorisë së Financave, pasi që ata kanë përgjegjësitë kryesore për planifikimin e buxheteve komunale. Përveç kësaj, analiza dëshmoi se gratë që përfitojnë subvencione komunale marrin më pak fonde se sa meshkujt, gjë që dëshmon domosdoshmërinë e kryerjes së një analize më të detajuar të buxheteve komunale nga këndvështrimi gjinor në të ardhmen. Prandaj, grupi rekomandoi që me buxhetim të përgjegjshëm gjinor të fillohet që nga viti i ri fiskal.

Bazuar në këtë, grupi organizoi tryeza të rrumbullakëta me qytetarë, aktivistë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të autoriteteve lokale, në të cilat paraqitën të gjeturat dhe u ftuan autoritetet lokale për të ndërmarrë masa përkatëse. Pjesëmarrësit në tryeza të rrumbullakëta u pajtuan se kjo iniciativë duhet të realizohet dhe se autoritetet lokale nga ajo nuk humbin gjë, ndërsa nga avancimi i barazisë gjinore dhe promovimi i të drejtave të grave mund të fitojnë shumë, në rast se i miratojnë propozimet dhe trajtojnë çështjet gjinore në buxhetin e vet për vitin fiskal vijues.


“Buxheti gjinor potencialisht duhet të mundësojë trajtim të barabartë të grave dhe burrave, të mundësojë veprime pozitive dhe masa speciale për çrrënjosjen e pabarazive historike në shoqëri. Ne jemi të vetëdijshëm që kjo është vetëm maja e akullnajës, por ne duhet të kemi një pikënisjeje dhe të inkurajojmë komunat tjera veriore të veprojnë ngjashëm.” – Dalliborka Rakic.

Grupi i anëtarëve më pas punoi në një draft deklarate e cila do të obligojë autoritetet lokale që të respektojnë kërkesat për barazi gjinore gjatë alokimit të subvencioneve. Grupi ia paraqiti atë Kryetarit të Komunës së Zubin Potokut, i cili u pajtua se



buxheti i përgjegjshëm gjinor do t'i sillte shumë përfitime komunës, por potencoi se procesi i sajimit të tij është mjaft kompleks. Për shkak se komuna sapo është krijuar dhe përballlet me shumë sfida, Kryetari i Komunës sugjeroi se do të përfshijë një komponentë të ndjeshme gjinore në buxhetin e vitit vijues dhe do të inkorporojë në të disa rekomandime specifike të grupit lidhur me alokimin e subvencioneve. Anëtarët e grupit nuk u dekurajuan nga kjo, por ishin të kënaqur me faktin që ishin në gjendje të krijojnë një bazë për hapat vijues në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, të cilën mund ta shfrytëzojnë në të ardhmen për ta inkurajuar kuvendin komunal që të veprojnë në këtë drejtim.

Pjesëmarrësit: Milica Andric, Radmila Kapetanovic, Ivana Nesovic, Daliborka Rakic, Milica Rakic, Natasa Trifunovic



SHENJAT TURISTIKE DHE SHTYLLAT UDHËZUESE

Grupi i APG nga Leposaviqi e dinte se ekzistojnë shumë institucione publike vendndodhjet e së cilave nuk i dinë as qytetarët e as studentët e shumë që nuk janë nga kjo komunë e të cilët nuk e njohin zonën sa duhet. Prandaj, grupi vendosi që të adresojë çështjen e etiketimit joadekuat të institucioneve si dhe mungesën e shenjave turistike dhe shtyllave udhëzuese.

“Ky problem dukej i theksuar dhe lehtë i menaxhueshëm në nivel lokal. Kjo është relevante për të gjithë ne, por ne nuk i kishim kushtuar sa duhet kujdes. Përveç faktit që do të lehtësojmë qarkullimin në qytet, ne do të krijojmë një bindje më të mirë për komunën tonë, duke u ofruar turistëve më shumë informata mbi atraksionet turistike.” – Marina Jakovljeviq

Grupi ka lansuar iniciativës me një anketim të studentëve dhe qytetarëve të Leposaviqit, me të cilën shtjellohej niveli i njohurive të qytetarëve me lokacionet e disa institucioneve të caktuara dhe vlerësohej nëse vendosja e shenjave turistike dhe shtyllave udhëzuese do të përmirësonte orientimin e tyre. Rezultatet konfirmuan se respondentët e anketës lokale nuk ishin mirë të informuar dhe se vendosja e tabelave në institucione dhe e shtyllave informative në rrugë do të ndihmonte në këtë aspekt. Përveç kësaj, rezultatet treguan

se respondentët besonin se shenjat turistike në hyrje dhe dalje të qytetit do të mund të ofronin informata të dobishme mbi monumentet historike për vizitorët dhe eventualisht do të mund ta shtonin numrin e tyre.

Kur grupi filloi aktivitetet e veta, rruga kryesore e Leposaviqit ishte duke u ndërtuar gjë që përbënte një mundësi të shkëlqyeshme për grupin që të përshijë kërkesën e vet brenda një projekti infrastrukturor aktual. Prandaj, grupi angazhoi një ekspert për të hartuar analizën e gjendjes aktuale dhe ofruar rekomandime mbi lokacionet në të cilat nevojiten mbishkrime dhe mbi llojet e caktuara të shenjave të domosdoshme. Raporti që doli nga ky angazhim përshinte edhe ridizajnimin e propozuar të shenjave aktuale dhe krijimin e një table informative dhe turistike në qendër të qytetit.

“Pasi që eksperti e hartoi dokumentin, ne e dorëzuam atë bashkë me kërkesën përkatëse tek Drejtoria e Urbanizmit. Ne kishim një ndjenjë të mirë se jemi në rrugë të duhur dhe se autoritetet lokale ishin të interesuara në propozimin tonë.” – Jellena Millosheviq

Përkundër hezitimit fillestar që kishim, duke menduar se Kryetari i Komunës nuk do ta përkrahte këtë nismë, grupi u takua me të për t’ia paraqitur punën e kryer. Ai e përkrahu




inicativën dhe sugjeroi që t’ia paraqesin idenë Kuvendit të Komunës. Sipas sugjerimit të tij, një nga anëtarët e grupit që është edhe anëtarë e kuvendit komunal, Jasmina Vukasinoviq, e paraqiti nismën dhe rekomandimet gjatë një dëgjimi publik të organizuar më 27 shtator 2016. Një ditë më pas, Kuvendi Komunal miratoi propozimin dhe përfshiu 10,000 euro për këtë projekt në buxhetin komunal të vitit vijues.

“Ishte ndjenjë e çuditshme kur dëgjua për vendimin e Kuvendit Komunal. Isha pak e befashuar fillimisht se sa shpejt kuvendi kishte vendosur për ta miratuar propozimin tonë dhe shumë e befashuar kur mora vesh se do të ndante edhe fonde për realizimin e tij. Pas këtij shoku fillestar, të gjithë ishim tejet të kënaqur që e kuptuam se arritëm të ndryshojmë diçka në komunitetin tonë,” – Andrijana Millunoviq

Ky rezultat ua dëshmoi anëtarëve të grupit se si gjërat mund të përmirësohen me vullnet të mirë dhe punë. Përveç kësaj, rezultati i arritur u jepte atyre motivimin për të vazhduar me angazhime për një të ardhme më të mirë për komunitetin e tyre.

Pjesëmarrësit: Marina Jakovljevic, Mila Kostic, Ana Milosevic, Jelena Milosevic, Milena Milosevic, Andrijana Milunovic, Sladjana Popovic, Jasmina Vukasinovic



SIGURIA NË TRAFIK NË AFËRSI TË SHKOLLAVE

Kjo iniciativë është realizuar në vitin 2014, në një kohë kur trafiku në veri të Kosovës ende nuk rregullohej tërësisht nga policia. Si rrjedhojë, motoristët nuk respektonin rregullat e trafikut dhe shkaktonin shumë aksidente trafiku. Në Zveçan, kjo përbënte problem të theksuar, pasi që të gjitha shkollat fillore ndodhen në qendër apo afër rrugëve më të frekuentuara. Trafiku i parregulluar përreth këtyre shkollave rrezikonte drejtpërsëdrejti sigurinë e nxënësve. Grupi PRL nga Zveçani e konsideronte këtë një çështje që duhet adresuar. Në bazë të një ankete të kryer tek prindërit, punonjësit e shkollave dhe policët, grupi identifikoi dy faktorë kryesorë që kontribuonin në këtë çështje: tejkalimi i shpejtësisë në afërsi të shkollave dhe mosorganizimi i trafikut gjatë kohës së ardhjes dhe largimit nga shkolla.

"Qëllimi ynë kryesor ishte që t'i udhëzojmë nxënësit e nivelit parashkollor se si të sillen në trafik dhe të përpiqemi të ndikojmë tek vendimmarrësit që të ndërmarin veprime të caktuara të cilat mund ta përmirësojnë sigurinë në trafik dhe në komunë në përgjithësi." - Stevan Gjokiq

Pas identifikimit të këtyre dy faktorëve, grupi vendosi kontakt me vendimmarrës të ndryshëm në komunë. Kjo u dëshmu

se përbën sfidë serioze për shkak të situatës së ndjeshme politike në atë kohë, si dhe mungesës së bashkëpunimit paraprak mes tyre, përfshirë këtu policinë dhe zyrtarët e shkollave. Megjithatë, falë këmbëngulësisë, grupi filloi bashkëpunimin me zyrën e Kryetarit të Komunës, që ishte identifikuar si aktor kyç për adresimin e sfidave në trafik, ndërsa që edhe vet ai u zotua se do ta përkrahë këtë nismë. Përmes zyrës së tij, grupi siguroi takime me shefin e policisë dhe të gjithë drejtorët e shkollave fillore në Zveçan.

"Përkrahja personale e Kryetarit të Komunës dhe tërë ekipit të tij për grupin dhe nismën tonë ishte shumë e dobishme dhe na e siguroi ndikimin që na nevojitej për të iniciuar diskutime dhe implementuar aktivitete." – Alleksandra Gjuriq

Pas prezantimit me kujdes të çështjeve dhe zgjidhjeve të mundshme, grupi siguroi përkrahjen e domosdoshme dhe miratimin nga policia dhe drejtorët e shkollave. Me bashkëpunim dhe ndihmë financiare të tyre, grupi lansoi një fushatë vetëdijësimi për qytetarët dhe OJQ-të lokale përmes mediave, aktiviteteve në rrugë dhe diskutimeve në shkolla me nxënës dhe prindër të tyre. Falë suksesit të përpjekjeve të veta avokuese, grupi organizoi orë të sigurisë në trafik me





të gjitha shkollat fillore të Zveçanit, të cilat mbaheshin nga një ekspert i sigurisë në trafik nga stacioni i policisë në Zveçan.

Si rezultat i kësaj iniciative, siguria në trafik filloi të konsiderohet nga Kryetari i Komunës dhe OJQ-të lokale si program i rëndësishëm për komunitetin. Shkurt pas kësaj, me përkrahje financiare nga ta, u vendosën shenja të reja trafiku në shkolla dhe filloi zbatimi më strikt i rregullave të trafikut nga policët, të cilët ishin të pranishëm afër shkollave edhe në fillim edhe në përfundim të orarit mësimor.

“Është kënaqësi t’i shohësh këto shenja të reja të trafikut, pengesa të shpejtësisë në rrugë dhe policë që kanë për qëllim sigurinë në trafik përreth shkollave. Ndihej mirë kur e di që isha pjesë e kësaj të arriture dhe mendoj se ngjashëm ndihen të gjithë anëtarët tjerë të grupit.” – Igor Dashi

Pjesëmarrësit: Igor Dasic, Stevan Djokic, Aleksandra Djuric, Ivana Dobric, Mirjana Markovic, Dejan Nedeljkovic, Milos Timotijevic



“Është me rëndësi të mbrojmë mjedisin, e për shkak të mungesës së një sistemi të organizuar për largimin e mbeturinave në komunë, ekosistemet mund të hasin në pengesa. Ndotja e niveleve të rrezikshme përbën rrezik edhe për kafshë edhe për njerëz. Raca njerëzore i ka borb natyrës. Kjo është jo vetëm e rëndësishme por edhe e domosdoshme në botën moderne.” - Sonja Sovrlliq.

Grupi PRL nga Leposaviqi konsideroi se mungesa e një sistemi të organizuar për largimin e mbeturinave në komunë dhe niveli i ulët i vetëdijes tek qytetarët lidhur me rëndësinë e një sistemi të tillë përbëjnë problem të theksuar me ndikim potencial shkatërrimtar. Ata donin ta ngritin vetëdijen lidhur me largimin joadekuat të mbeturinave, të inkurajojnë aktivizëm më të shtuar tek të rinjtë në kuptim të mbrojtjes së mjedisit, dhe të ngritin vetëdijen e publikut lidhur me ndarjen e mbeturinave, si parapërgatitje për reciklim pasi që komuna të ketë krijuar stabilimentet e duhura. Përveç kësaj, ata donin të iniciojnë një diskutim publik mes qytetarëve dhe zyrtarëve komunalë lidhur me këtë çështje.

“Duke qenë pjesë e grupit avokues EKOsaveic, si pjesë e Programit për të Rinjtë për Leadership të NDI, unë isha në gjendje të marr pjesë në diskutime në tryeza të rrumbullakëta me akterë të ndryshëm, por edhe të punoj në rekomandime konkrete dhe të bëjë propozime për veprime të mëtejme. Tërë kjo më ka bërë të besoj që duhet të marr pjesë në procese të ndryshme për vendime që prekin jetën tonë të përditshme.” – Jovana Radosavleviq

Grupi realizoi shumë aktivitete të ndryshme, përfshirë një aktivitet në natyrë në të cilin përdori CD të vjetra e të hedhura në mbeturina, shishe të lëngjeve, kuti dhe gjësende tjera të panevojshme dhe i ktheu ato në vepra arti. Kur qytetarët afroheshin për t'i parë këto vepra, grupi u tregonte lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe organizimit të largimit të mbeturinave. Përveç kësaj, grupi organizoi takime dhe tryeza të rrumbullakëta me anëtarë të kuvendeve komunale, përfaqësues të shkollave, media, etj. në mënyrë që në këtë çështje të angazhohen sa më shumë akterë që është e mundur.



Si rezultat i kësaj iniciative, autoritetet komunale kanë vendosur më shumë kontejnerë mbeturinash në pika të caktuara dhe kanë iniciuar diskutime me OJQ lokale dhe ekspertë lidhur me qasjet strategjike ndaj kësaj çështjeje. Ndërtimi i deponisë rajonale të reciklimit, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, do duhej të ofrojë një zgjidhje më stabile për këtë problem.

Pjesëmarrësit: Branko Bojovic, Brankica Janicijevic, Andrijana Milutinovic, Jovana Radosavljevic, Tijana Sekulic, Sanja Sovrlic Radmila Vukicevic



Ngritja e vetëdijes së qytetarëve rreth hedhjes së mbeturinave në komunë



Ngritja e vetëdijes rreth hedhjes së mbeturinave, inkurajimi i aktivizmit të rinjve dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut për riciklim



Sigurimi i mbështetjes përmes rrjeteve sociale, mediave tradicionale, dhe aktivitete në terren



Aktivitetet në ambient të hapur me qytetarë, vizita studimore me nxënës dhe tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues komunal



Autoritetet komunale kanë vendosur më shumë kontejnerë të mbeturinave dhe kanë iniciuar bisedime me ekspertë dhe OJQ-të lokale

DREJTORIA E RINISË

Kosova ka popullatën më të re në Evropë, duke qenë se 53% e popullatës së saj është nën moshën 25-vjeçare. Kosova ka gjithashtu një prej normave më të larta të papunësisë në rajon, rreth 35 për qind, ndërsa norma e papunësisë mes të rinjve arrin gati 60 për qind.

Ngjashëm me shumë komuna tjera në Kosovë, pothuajse gjysma e banorëve të Zubin Potokut janë nën moshën tridhjetëvjeçare. Edhe pse ka pasur shumë interes nga palë të ndryshme interesi për tu ndihmuar të rinjve në Zubin Potok, këto përpjekje kryesisht nuk kanë qenë të koordinuara. Ky konkluzion është bazuar në hulumtimin e kryer nga grupi i PRL në Zubin Potok, mes të rinjve të komunës. Të dhënat zbuluan se të rinjtë në këtë komunë kryesisht ishin të painformuar lidhur me përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga akterë të ndryshëm. Kjo ngjau përkundër aktiviteteve të shumta të donatorëve të ndryshëm, OJQ-ve dhe iniciativave qytetare, të cilat shpesh dyfishoheshin apo përsëriteshin pa ofruar ndonjë rezultat të qëndrueshëm. Pas rishikimit të strategjive të ndryshme në rajon, grupi vendosi që një nga praktikatat më efektive është krijimi i një organi komunal i cili do t'i koordinonte këto përpjekje dhe ofronte një strategji më të gjerë për t'u ofruar të rinjve udhëzime dhe përkrahje.

"Të rinjve u nevojitet përkrahje. Përkrahja sistematike, e organizuar dhe e përhershme. Kjo lloj përkrahjeje për të rinjtë nënkupton një të ardhme të sigurt dhe cilësore për komunën tonë, zhvillimin e mëtejme ekonomik të saj, rritjen e normës së natalitetit dhe krijimin e kushteve për jetë më të mirë në të." – Millija Bishevac

Në bazë të kësaj, grupi vendosi të inkurajojë autoritetet lokale që të krijojnë Drejtorinë e Rinisë. Kjo zyrë do të shërbejë si pikë kontakti mes të rinjve dhe komunës, duke ofruar një forum ku të rinjtë mund të shprehin problemet e tyre dhe të angazhohen në planifikim dhe vendimmarrje që preken ata. Kjo zyrë do të ofronte edhe udhëzime për të rinjtë, një strategji për përkrahjen e tyre si dhe do të koordinonte akterët e ndryshëm në këtë fushë.

Pas identifikimit të këtij qëllimi madhor të iniciativës së vet, grupi organizoi aktivitete për të ngritur nivelin e përkrahjes për këtë drejtori komunale në mesin e të rinjve. Pas disa evenimenteve në të cilat biseduan me qytetarë, Kryetarin e Komunës





dhe anëtarë të Kuvendit Komunal, grupi përgatiti një peticion publik për t'ia dorëzuar autoriteteve komunale me qëllim të inicimit të një diskutimi zyrtar.

Si rrjedhojë, grupi, bashkë me një OJQ lokale, hartuan dhe dorëzuan tek autoritetet komunale strategjinë për "Zhvillimin

e rinisë në komunën e Zubin Potokut". Kjo strategji u pranua në një takim të përbashkët mes përfaqësuesve të komunës dhe OJQ-ve lokale që merreshin me çështje rinore. Pas këtij takimi, grupi avokoi pranë zyrës së Kryetarit të Komunës që të emërojnë një individ përgjegjës për mbikëqyrjen e çështjeve dhe zhvillimit rinor. Pas krijimit të kësaj pozite, Kryetari i Komunës përzgjedhi një anëtar të grupit për ta mbajtur atë.

Anëtarët e nismës vazhdojnë të përcjellin vendimet komunale mbi këtë temë.

"Ne jemi të vetëdijshëm mbi ndjeshmërinë e situatës politike në veri të Kosovës, por duam të sigurohemi që përpjekjet tona do të vazhdojnë të mbijetojnë përmes angazhimit tonë në aktivitete të OJQ-ve të ndryshme, si dhe përmes vendimeve komunale." – Millosh Peroviq

Pjesëmarrësit: Milija Bisevac, Uros Bozovic, Nemanja Galjak, Milos Perovic, Marko Rakic



Përmirësimi i vetëdijës në mes të rinjve për përpjekjet dhe mundësitë që ofrohen nga akterë të ndryshëm



Të inkurajohet kuvendin komunal për të krijuar Drejtorinë e Rinisë



Sigurimi i mbështetjes përmës rrjeteve sociale dhe medieve tradicionale, dhe aktivitete në terren



Hartimi dhe dorëzimi i strategjisë "Zhvillimi i Rinisë në Komunën e Zubin Potokut" të përfaqësuesë e Komunës



Një person është emëruar në Kabinetin e Kryetarit si përgjegjës për mbikëqyrjen e çështjeve për të rinj në komunë

RINIA PËR SPORT

Në vitin 2015, komuna e Mitrovicës së Veriut nuk kishte objekte ku do të mund të takohej dhe zhvillonte veprimtari sportive apo tjera komuniteti i vet rinor. Grupi nga kjo komunë e konsideroi këtë si barrierë për zhvillimin adekuat rinor dhe përfshirjen në komunitet, prandaj edhe vendosi të bëjë diçka për këtë çështje.

"Ideja e këtij projekti është që të kemi ndikim pozitiv në zhvillimin psikofizik të rinisë, si dhe në socializimin e tyre, që është i një rëndësie të veçantë sot kur rrjetet sociale po zënë vend kryesor në vëmendjen e të rinjve." – Zoran Mojsilloviq

Për të dëshmuar këtë, grupi kreu një hulumtim të opinionit publik lidhur me rëndësinë e kësaj çështjeje për qytetarët e Mitrovicës së Veriut. Përmes këtij hulumtimi, grupi gjithashtu identifikoi një problem tjetër: gjendjen e keqe të fushave sportive ekzistuese dhe mungesën e vetëdijes tek të rinjtë lidhur me përgjegjësinë personale për të mbrojtur këto fusha dhe për tu kujdesur për to.

Për të adresuar këto dy çështje, grupi së pari i fokusoi iniciativat e tyre avokuese tek autoritetet lokale, duke organizuar takime me përfaqësues komunalë. Gjatë këtyre

takimeve, grupi sqaroi çështjet e identifikuar përmes hulumtimit të opinionit publik. Përfaqësuesit komunalë e kuptuan nevojën për të ndërtuar objekte rinore dhe u pajtuan që të punojnë përkrah grupit për të gjetur zgjidhjet e duhura. Më pas, grupi i orientoi përpjekjet e veta avokuese drejt qytetarëve të Mitrovicës së Veriut, me qëllim të ngritjes së vetëdijes lidhur me nevojën për të ruajtur infrastrukturën aktuale dhe për të krijuar infrastrukturë të re sportive. Kjo u kuptua dhe u përkrah në tërësi nga përfaqësuesit komunalë. Duke shfrytëzuar kanale të mediave sociale dhe komunikimit direkt përmes aktiviteteve të ndryshme publike, grupi punoi në informimin e qytetarëve mbi rëndësinë e këtyre dy qëllimeve.

"Ne duhet t'u mundësojmë të rinjve pjesëmarrjen në sport, gjë që do të ndikojë edhe në qasjen e të rinjve ndaj jetesës së shëndetshme." – Jellena Kasalloviq

Me përkrahje të zyrtarëve komunalë, grupi organizoi një turne në streetball, nën moton: "Bëhu pjesë e ndryshimit pozitiv të cilin dëshiron ta përjetosh." Përmes mediave sociale, grupi promovoi turneun dhe grumbulloi disa ekipe të streetballit për të garuar në të. Turneu u zhvillua në njërin nga terrenet





e porsarenovuara të basketbollit, me çka u theksua rëndësia e mesazhit të dhënë. Ky eveniment u shfrytëzua edhe për të promovuar një shembull pozitiv të bashkëpunimit mes autoriteteve lokale dhe rinisë në Mitrovicën e Veriut.

Si rezultat i përpjekjeve të grupit, si dhe falë gatishmërisë së autoriteteve lokale për të përkrahur rininë, të rinjtë e Mitrovicës së Veriut fituan një mundësi më shumë. Pas iniciativës së grupit, anëtarët e tij u ftuan nga përfaqësuesit e komunës në një takim në të cilin u informuan lidhur me hapat e ri që komuna i ka ndërmarrë, përfshirë parashtrimin e propozimeve pranë Zyrës së BE-së në Kosovë për ndërtimin e fushave të reja sportive, si dhe lidhur me fondet komunale të ndara për ndërtimin dhe renovimin e parqeve dhe fushave të sportit për më të rinjtë e komunës.

“Ne jemi të vetëdijshëm që duhet të bëjmë shumë më shumë, dhe jemi të përkushtuar që të arrijmë misionin e nismës sonë. Ne do të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim, përkrah OJQ-ve tona lokale dhe iniciativave të vogla qytetare.” – Jelena Kosallovic

Pjesëmarrësit: Sanja Bogosavljevic, Jasmina Dedic, Milica Djordjevic, Jelena Kasalovic, Tijana Kolutac, Zoran Mojsilovic



LIRIA E LËVIZJES PËR TË GJITHË

Përderisa ligjet e Kosovës rregullojnë dhe mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ato nuk implementohen në tërësi në terren, pasi që ka shumë objekte publike të cilat nuk u ofrojnë personave me aftësi të kufizuara qasjen që u garantohet me ligj.

Të përkushtuar për ta adresuar këtë pabarazi, grupi nga komuna e Leposaviqit themeloi iniciativën “Liri e lëvizjes për të gjithë”, me qëllim të ofrimit të zgjidhjeve potenciale për autoritetet lokale, në mënyrë që ata të mund të ndërmarrin masa konkrete. Kjo iniciativë kishte për cak ofrimin e ndihmës për persona me aftësi të kufizuara, me fokus të veçantë tek personat që shfrytëzojnë karroca. Pasi që veç ekzistonte obligimi ligjor për tu ofruar personave me karroca qasje në ndërtesa, grupi filloi punën e vet duke ngritur vetëdijen e përfaqësuesve të komunës dhe qytetarëve lidhur me moszbatimin e këtij ligji në Leposaviq. Përveç kësaj, grupi komunikoi me të gjitha organizatat dhe asociacionet tjera për të adresuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në komunë.

“Ne duhet të respektojmë më shumë nevojat dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Leposaviqit, si dhe të sigurojmë implementim më të fuqishëm dhe kuptimplotë

të rregulloreve ligjore për kushtet teknike në ndërtesa publike. Shpresojmë se në të ardhmen ndërtesat nuk do të marrin pëlqimin e komunës për ndërtim nëse dizajni i tyre nuk është në pajtueshmëri me të gjitha rregulloret përkatëse.” – Marina Jakovljeviq

Duke realizuar një vlerësim të institucioneve publike në komunë, me fokus të theksuar në institucionet që ofrojnë shërbime direkte për persona me aftësi të kufizuara, grupi identifikoi dy institucionet kryesore publike që nuk ofronin qasje të duhur: shkollën fillore dhe zyrën e postës. Grupi më pas shfrytëzoi mediat dhe rrjetet sociale për të mobilizuar sa më shumë individë dhe organizata që ishte e mundur për ta përkrahur këtë projekt. Grupi gjithashtu u konsultua me një ekspert lokal lidhur me krijimin e një politike dhe propozimit teknik për të zgjidhur problemet e qasjes në këto institucione.

“Qëllimi kryesor i kësaj iniciative është të avancohet liria e lëvizjes për persona me aftësi të kufizuara, përmes ngritjes së vetëdijes së miqve dhe fqinjëve lidhur me problemin e tyre. Përveç kësaj, na duhej të nxisim diskutime me institucione të ndryshme që janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për këtë grup qytetarësh.” – Bojana Jeleniq





Pasi që tërhoqën vëmendjen e autoriteteve lokale tek kjo çështje, propozimi përfundimtar i grupit iu dorëzua zyrës së kryetarit të komunës. Më pas ai u shqyrtua nga stafi i autorizuar dhe u pranua zyrtarisht nga komuna, e cila ndau edhe buxhetin e nevojshëm për të bërë ndryshime strukturore në ndërtesa. Zyra e Kryetarit të Komunës e inkurajoi grupin që të vazhdojë së punuari në këtë çështje dhe në çështje tjera të rëndësishme për komunitetin.

Pjesëmarrësit: Marina Jakovljevic, Bojana Jelenic, Mirjana Jevtic, Aleksandar Kostic, Slavko Simic



NDALJA E DHUNËS NË SHKOLLA

Në tërë veriun e Kosovës dhuna mes nxënësve moshatarë nëpër shkolla shfaqet në mosha shumë të hershme. Kjo konfirmohet me numrin e madh të raportimeve të dhunës mes moshatarëve në shkolla dhe media. Si rrjedhojë, grupi nga Zveçani vendosi të adresojë këtë problem në rritje përmes iniciativës së vet avokuese **“Shkolla pa dhunë”**.

“Ngacmimi në shkollë nuk përbën fenomen social të izoluar. Ai është pjesë e një forme komplekse të komunikimit social në shoqërinë moderne. Shumë faktorë socialë gjenerojnë këtë sjellje dhe e bëjnë atë një nga problemet kryesore me të cilat përballen komunitetet moderne sot. Në literaturën e sociologjisë, format e ndryshme të dhunës në shkolla interpretohen si produkt i krizës sociale, apo si lloj i simptomës së kulturës së dhunës që është në rritje.” - Ivana Vukasinoviq.

Për të kryer një vlerësim më të mirë të situatës, grupi ka kryer vizita në terren në katër shkolla në Zveçan dhe ka biseduar me përfaqësuesit e tyre. Ai gjithashtu ka kryer një anketë me prindër dhe fëmijë që vijnë në mësimin në këto shkolla, të cilët e konfirmuan rëndësinë e adresimit të kësaj çështjeje.

“Gjatë bisedave me përfaqësues të shkollave, kemi kuptuar shumë pengesa me të cilat këto shkolla përballen çdo ditë. Të dyja

grupet, edhe mësimdhënësit edhe prindërit, na dhanë përkrahje të plotë për ta ngritur këtë çështje më tej.” – Miodrag Radenkoviq, udhëheqës i grupit

Përmes kësaj iniciative, grupi organizoi nga dy tryeza të rrumbullakëta për diskutime në secilën prej këtyre katër shkollave. Nga një tryezë e rrumbullakët u organizua me përfaqësues të shkollave dhe nga një me prindër. Tema kryesore e tyre ishte diskutimi i arsyeve për shtimin e dhunës dhe shtjellimi i zgjidhjeve potenciale për këtë problem.

“Adresimi i problemit të dhunës në shkolla dhe sigurimi që fëmijët ndihen të sigurt në to është një nga parakushtet e arsimimit cilësor.” – Miodrag Radenkoviq

Në bazë të rekomandimeve nga diskutimet e zhvilluara në tryeza të rrumbullakëta, grupi zhvilloi dy aktivitete. Së pari, me ndihmën e dy ekspertëve lokal hartoi një propozim politik me disa rekomandime për administratorë të shkollave, duke i listuar hapat që duhet ndërmarrë për ta adresuar me sukses këtë çështje në të ardhmen. Hapat janë: krijimi i ekipeve për parandalimin e dhunës në shkolla dhe njoftimi i publikut lidhur me ekzistimin e këtyre ekipeve; diskutimi i obligueshëm i kësaj teme në bordin e shkollës dhe në





takime mësimdhënës-prindër; vendosja e kutive për lajmërim anonim të rasteve dhe shfrytëzimi i mediave sociale për të raportuar dhunën në shkollë; dhe trajnimi i ndërmjetësuesve mes moshatarëve. Më pas, grupi organizoi disa orë mësimore për ndërmjetësim mes moshatarëve dhe komunikim jo të dhunshëm në secilën shkollë, për të ngritur kapacitetet e nxënësve dhe bërë që ata të marrin përsipër rol më aktiv në parandalimin e konflikteve para eskalimit të tyre.

Pas shqyrtimit nga organi përkatës, propozimi politik i grupit u pranua nga të gjitha shkollat fillore në Zveçan. Rekomandimet e tij janë përfshirë në strategjinë vjetore të vitit 2015 për adresimin e dhunës në shkollë, ndërsa disa prej janë përfshirë edhe në vitet vijuese.

Pjesëmarrësit: Jovan Milosavljevic, Milena Jevtic, Miodrag Radenkovic, Ivana Vukasinovic



LE TË JETË PASTËR

Komuna e Zubin Potokut ka mundësi të mirë për zhvillim ekonomik përmes turizmit, sepse posedon një mjedis natyror të bukur, që përshkohet me male dhe një liqen. Autoritetet lokale e kanë kuptuar këtë dhe në vitin 2014 Zubin Potoku morri statusin e një eko-komune. Megjithatë, për të implementuar me sukses eko-planin komunal, autoriteteve u nevojitej përkrahje nga qytetarët. Nga rezultatet e hulumtimit të opinionit publik, grupi nga Zubin Potoku kuptoi se niveli i ulët i vullnetarizmit dhe vetëdijes të qytetarëve, si dhe mungesa e një strategjie komunale për mbrojtje të mjedisit, po e pengonin këtë përpjekje.

Me qëllim të përkrahjes së komunës në përpjekjet e veta për të qenë komunë ekologjike, grupi inicioi iniciativën avokuese **“Le të jetë pastër”**, për të ngritur vetëdijen mes qytetarëve që jetonin në hapësirat e mbipopullara rreth lumit Ibër, si dhe për të motivuar qytetarët e kësaj zone që të paraqiten vullnetarë për të pastruar lagjet e tyre.

“Hulumtimi ynë ka dëshmuar se lumenjtë më të vegjël, që vendburimin e kanë në zonat më të larta të komunës sonë, janë zakonisht vende në të cilat qytetarët hedhin mbeturinat e tyre. Të gjitha këto mbeturina shkarkohen në lumin Ibër dhe krijojnë probleme vërtetë të mëdha për njerëzit që jetojnë pranë shtratit të lumit. Krahas mungesës së një deponie dhe largimit të organizuar të mbeturinave në veri të Kosovës, kjo paraqet një problem të madh për komunën.” – Millica Bozhoviq

Grupi ka organizuar disa aktivitete publike në të cilat ka shpërndarë materiale promovuese që përmbanin të dhëna lidhur me çështjen. Përveç kësaj, grupi incizoi një video-dokumentar lidhur me gjendjen e mjedisit në Zubin Potok, me përkrahje nga një TV stacion lokal. Në këtë dokumentar, anëtarëve të grupit iu bashkëngjiten ekspertë mjedisorë, të cilët flisnin për rreziqet e mundshme me të cilat përballëj Zubin Potoku nëse ndotja mbetet në të njëjtin nivel, si dhe për zgjidhjet e mundshme për situatën e krijuar. Grupi ia paraqiti këtë video të shkurtër dhe informatat tjera të ngjashme nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme në Zubin Potok, falë ndihmës së drejtorëve dhe mësimeve në këto shkolla.

Njëkohësisht, grupi iu drejtua autoriteteve lokale, duke punuar dhe duke iu qasur zyrës së Kryetarit të Komunës nga e cila kërkoi organizimin e një tryeze të rrumbullakët për të diskutuar mbi mbrojtjen mjedisore në komunë. Grupi shprehu nevojën



për një qasje më strategjike ndaj kësaj çështjeje dhe kërkoi bashkëpunim të shtuar mes autoriteteve komunale, qytetarëve që jetojnë pranë zonave të ndotura, kompanisë rajonale të mbeturinave dhe organizatave të shoqërisë civile, me qëllim të sigurimit të përkrahjes për aktivitetet e veta dhe për të parandaluar ndotjen e mëtejme.

Pas disa muajsh angazhimi në informim të publikut, grupi arriti të motivojë qytetarët që të marrin pjesë në pastrimin vullnetar të zonave të ndotura. Kjo ngjarje u koordinua nga grupi dhe u përkrah nga kompania komunale e pastrimit, e cila ofroi makinerinë e nevojshme për këtë aktivitet. Me këtë rast, u larguan disa pirgje mbeturinash rreth lumit Ibër, ndërsa në të njëjtat vende komuna shpërndau kontejnerë të rinj.

Në fund, disa organizata joqeveritare lokale iniciuan diskutime me qytetarë dhe autoritete komunale lidhur me zhvillimin e një strategjie komunale për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të komunës, në të cilat u ftua të marrë pjesë edhe grupi.

“Për neve është e natyrshme të punojmë në parandalimin e krijimit të deponive të egra të mbeturinave dhe të zbusim ndotjen e lumit për aq sa është e mundur. Është kënaqësi të shohim se shumë grupe, organizata dhe individë po e përkrahin këtë ide.” – Tijana Krasiq

Pjesëmarrësit: Ivan Bozovic, Milica Bozovic, Tijana Krasic, Lazar Rakic, Branka Utvic, Zoran Utvic



Komuna e Mitrovicës së Veriut, si një nga qendrat kryesore arsimore dhe mjekësore të vendit, ofron më shumë shërbime publike se sa shumica e komunave tjera të Kosovës. Si komunë me mbi 10,000 studentë, shumica e së cilëve nuk janë nga kjo komunë, mungesa e shenjave të trafikut që shpijnë tek institucionet kryesore publike përbënte brengë për qytetarët.

Pasi që autoritetet zyrtare nuk po ndërmerrnin asgjë për këtë çështje, grupi PRL nga Mitrovica e Veriut lansoi një nismë për t'ia tërhequr vëmendjen autoriteteve komunale drejt këtij problemi dhe zgjidhjeve të mundshme.

"Ekziston nevoja dhe kërkesa për udhëzues rrugorë për studentë dhe vizitorë, falë të cilëve do të parandalohej sorollatja e kotë nëpër komunë duke kërkuar institucione të ndryshme, siç janë spitali, policia, muzeu, biblioteka, shkolla, fakultetet e ndryshme, teatri, stacioni i autobusëve, gjykata, etj." – Stefan Nedelković

Grupi shfrytëzoi mediat tradicionale dhe sociale, si dhe aktivitetet rrugore, për të shtuar përkrahjen publike dhe presionin ndaj autoriteteve komunale për të vepruar në këtë drejtim. Shumë të rinj dhe institucione publike, si dhe universiteti, e përkrahën këtë iniciativë.

Më pas, grupi vizitoi përfaqësuesit e komunës për të diskutuar iniciativën dhe qëllimet e saj. Gjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit komunalë folën për veprimet të cilat veç i kanë ndërmarrë e madje edhe i sugjeruan grupit disa aktivitete që mund t'i ndërmerr ai.

"Kishim përkrahje për këtë iniciativë, ndërsa edhe komuna e kuptoi se ka nevojë për shenja të tilla rrugore. Kjo ishte shumë inkurajuese për ne." – Ida Xheković

Bazuar në të gjitha informatat e grumbulluara përmes hulumtimit, bisedave me qytetarë dhe institucione publike, si dhe në informatat e ofruara nga autoritetet lokale, grupi hartoi një propozim politikë. Me përkrahje të ekspertit lokal të planifikimit



urban dhe përfaqësuesve të komunës, grupi fillimisht identifikoi institucionet publike me interes të veçantë që duhet shënjuar dhe më pas udhëkryqet dhe lokacionet në komunë në të cilat duhet vendosur shenjat. Ata gjithashtu ekzaminuan planet komunale të vendosjes së shenjave të trafikut, buxhetin komunal, legjislacionin relevant, etj. Më pas, grupi hartoi projekt propozimin me zgjidhjet e mundshme, në të cilin identifikoheshin institucionet e rëndësishme të veçantë, pikat në trafik ku duhet vendosur shenjat, trafikun në ato pika dhe implikacionet për buxhetin komunal.

Pas përfundimit të këtij projekt propozimi, grupi organizoi edhe një takim me përfaqësuesin e komunës për t'i dorëzuar atë dhe për të diskutuar mbi bashkëpunimin në të ardhmen. Përfaqësuesi shprehu entuziazëm për propozimin dhe gatishmërinë e komunës për ta përfshirë atë në diskutimet e kuvendit komunal pas zgjedhjeve të vitit 2017.

"Pasi që shumica e anëtarëve të grupit të PRL janë studentë të arkitekturës, ne do të vazhdojmë të përkrahim dhe vlerësojmë veprimet e ardhshme të komunës në këtë drejtim." – Tijana Jevtic

Pjesëmarrësit: Petar Djordjevic, Ida Dzekovic, Tijana Jevtic, Stefan Nedeljkovic, Aleksandra Zivkovic




Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe autoriteteve lokale rreth mungesës së shenjave rrugore për në institucionet kryesore publike



Institucionet duhen t'i sistemojnë dhe t'i vendosin shenjat rrugore



Sigurimi i mbështetjes online



Hartimi dhe dorëzimi i politikave publike tek përfaqësuesit komunal



Qeverisja lokale miraton politikat

ALTERNATIVA

Komuna e Leposaviqit ndodhet në veri të Kosovës dhe në të jetojnë rreth 18,000 banorë. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, tre nga dhjetë serbët e zgjedhur në Kuvend vinin nga Leposaviqi, megjithatë, qytetarët shpesh shprehnin pakënaqësinë e tyre me komunikimin sporadik me përfaqësuesit e tyre politikë, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Grupi i PRL nga Leposaviqi vendosi të bëjë diçka lidhur me këtë dhe lansoi iniciativën avokuese të quajtur **“Alternativa”**.

Si hap të parë, kjo iniciativë kreu një hulumtim për të kuptuar më mirë arsyet e kësaj pakënaqësie, duke biseduar drejtpërdrejt me qytetarë dhe me përfaqësuesit politikë të tyre. Ata donin të dinë nëse pakënaqësia buronte nga mungesa e përpjekjeve të përfaqësuesve të zgjedhur apo nga mosinformimi adekuat i qytetarëve. Në bazë të rezultateve të këtij hulumtimi, grupi përcaktoi se të dy këta faktorë kishin ndikim në problemin në fjalë dhe se të dyja palët shprehën interes për ta përmirësuar komunikimin, gjë që përbënte një të gjetur inkurajuese për grupin.

“Në bazë të të gjeturave tona, përkundër pretendimeve të tyre për komunikim të rregullt me qytetarë, përfaqësuesit tanë politikë besojnë se komunikimi mund të bëhet në baza më të rregullta. Ne këtë e konsiderojmë mundësi të mirë. Ne planifikojmë ta shfrytëzojmë grupin tonë si katalizator për iniciimin e një komunikimi dhe diskutimi më cilësor mes qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre.” – Bojan Millosavljeviq

Grupi dëshironte të krijojë një platformë për tu dhënë qytetarëve mundësi që të flasin drejtpërsëdrejti me përfaqësuesit e vet në Kuvendin e Kosovës. Për të arritur këtë, Alternativa filloi realizimin e një fushate mediale me fletushka, posterë, postime në Facebook, media tradicionale dhe komunikim direkt, për të promovuar debatet publike të qytetarëve me përfaqësuesit politikë të tyre. Këto debate do të fokusoheshin në çështje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen politike të qytetarëve dhe pengesat, sfidat dhe mundësitë e ndryshme për qytetarët e Leposaviqit.

Në të njëjtën kohë, grupi mbajti disa takime me përfaqësues politikë nga Leposaviqi për t’ua paraqitur atyre nevojën për këto debate dhe dobitë e tyre për deputetët e Kuvendit të Kosovës. Pasi ua shfaqti rezultatet e hulumtimit publik, të cilat





konfirmonin se qytetarët kanë interesim për komunikim më të ngushtë me përfaqësuesit e tyre, grupi arriti t'i motivojë deputetët që të marrin pjesë në këto diskutime.

Si rezultat i drejtpërdrejtë i kësaj, e në bazë të kërkesave të deputetëve, grupi organizoi tri debate publike në komunën e Leposaviqit. Pas vendimit për tu fokusuar në grupet të cilat shpesh neglizhohen, debati i parë u fokusua në pjesëmarrjen e grave e i dyti në pjesëmarrjen e rinisë. Në debatin e tretë të ftuar ishin qytetarët tjerë. Përfaqësuesit politikë nga Leposaviqi shfrytëzuan sugjerimet nga grupi i PRL dhe qytetarët për të filluar punën e tyre në strategjitë për përmirësim të komunikimit me qytetarët e komunës së tyre.

"Kjo ishte tejet e dobishme për ne si përfaqësues të zgjedhur të serbëve të Kosovës. Aktivitetet e ngjashme me këtë do të na ndihmojnë të zhvillojmë një qasje më të mirë për problemet ditore të qytetarëve tanë. Gjithashtu, takimet si kjo na ofrojnë ide se si të përmirësojmë dhe shtojmë komunikimin me qytetarë." – Nënkrjetari i Kuvendit Sllavko Simiq

Pjesëmarrësit: Sava Markovic, Bojan Milosavljevic, Zorica Milosavljevic, Sladjana Simic, Dalibor Stefanovic, Nevena Antonijevic



NUP (Dhuna në familje)

Dhuna në familje është çështje komplekse që nuk njihet klasë shoqërore, racë, moshë, religjion, kulturë apo nivel të pasurisë, duke prekur të gjitha shtresat e shoqërisë. Edhe pse gratë janë shumë më të prekura nga ky fenomen, viktimat e dhunës në familje mund të jenë të dyja gjinitë. Megjithatë, shpesh nuk ka të dhëna të sakta lidhur me përmasat e këtij problemi. Pikërisht këtë e kuptoi grupi PRL nga Zubin Potoku gjatë diskutimit të kësaj çështjeje me akterë të ndryshëm. Si pasojë, grupi vendosi të grumbullojë sa më shumë të dhëna që të jetë e mundur dhe t'i publikojë ato.

“Dhuna në familje është padyshim problem serioz i shoqërisë moderne dhe do duhej trajtuar si i tillë. Grumbullimi i të dhënave është nga hapat që duhet ndërmarrë për ta luftuar këtë fenomen, por përbën hap shumë të vështirë për shkak të kompleksitetit dhe ndjeshmërisë së kësaj teme.” – Danijella Jovanoviq

Pas konsultimeve me institucione të ndryshme publike që drejtpërsëdrejti merren me raste të dhunës në familje, grupi ndau hulumtimin e vet në dy kategori. Së pari, grupi iu qas disa institucioneve lokale, siç janë komuna, stacioni lokal i policisë, shtëpia e shëndetit dhe shkollat lokale. Më pas, ai grumbulloi të dhënat nga qytetarët. Gjatë këtij hulumtimi, grupi kreu mbi 300 anketa mes qytetarëve dhe mbi 50 intervista me punonjës të institucioneve të lartëpërmendura. Me përkrahje nga një ekspert i dhunës në familje, grupi i procesoi të gjitha të dhënat dhe përgatiti një prezantim për akterët lokalë.

Grupi i paraqiti këto të dhëna në një tryezë të rrumbullakët të organizuar me përfaqësues komunalë, si dhe përfaqësues të të gjitha institucioneve që kishin kontribuar në hulumtim. Qëllimi i saj ishte t'u ofroheshin akterëve të ndryshëm të dhëna konkrete të cilat do t'u ndihmonin në përkrahjen e viktimave të dhunës në familje dhe parandalimin e dhunës në familje. Pas paraqitjes së të gjeturave të hulumtimit, grupi hapin diskutimin gjatë të cilit u dhanë disa rekomandime për një qasje më strategjike dhe institucionale ndaj kësaj çështjeje. Pas tryezës së rrumbullakët, këto rekomandime u përmbledhën në një dokument i cili iu shpërnda të gjitha institucioneve të përfshira në këtë projekt hulumtues.






"Çfarëdo përgjigje efektive ndaj dhunës në familje duhet të ketë trajtën e një strategjie vërtetë të integruar qendrore, që ngërthen punën e të gjitha drejtorive dhe dikasterëve qeveritarë, policisë, institucioneve shëndetësore, sociale dhe të gjitha agjencive tjera që luajnë rol aktiv në adresimin e këtij problemi." – Ivana Neshoviq

Edhe pse qëllimi kryesor i kësaj iniciative u arrit me paraqitjen e të dhënave, grupi ka vazhduar punën e vet në vetëdijësimin mbi dhunën në familje.

Pjesëmarrësit: Milena Bozovic, Mila Bulatovic, Danijela Jovanovic, Ivana Nesovic, Milan Trifunovic



BIKE BOOM

Për shumë të rinj nga komuna e Zveçanit ka qenë pothuajse e pamundur që të ngasin biçikleta në qytet, duke qenë se nuk ka pasur shtigje të ndara për këtë qëllim. Pa shtigje të dedikuara për këtë qëllim, çiklistët detyrohen të ngasin biçikletat e tyre në rrugë pa kurrfarë mbrojtje nga trafiku lokal. Grupi i PRL nga Zveçani vendosi të adresojë këtë çështje, në dobi të komunitetit.

“Në mungesë të objekteve ku do të mund të zhvilloheshin aktivitete kreative kulturore apo rekreacion, si dhe marrë parasysh fondet e pamjaftueshme, të rinjtë kryesisht kalojnë kohën e tyre duke shikuar TV, duke u angazhuar në rrjete sociale si nëpër kafene. Si një entuziast i madh i çiklizmit dhe sportit, mendoj se organizimi i infrastrukturës për çiklizëm është një nga zgjidhjet më të mira për këtë problem.” – Vlladimir Vučković

Grupi vendosi të avokojë pranë institucioneve, qytetarëve dhe organizatave sportive për krijimin e shtigjeve zyrtare për çiklizëm. Përmes aktiviteteve të ndryshme, promovimit në media tradicionale dhe sociale, si dhe takimeve direkte me përfaqësues të autoriteteve lokale, grupi mëntonte të fitojë përkrahje për këtë çështje dhe të marrë ide për zgjidhjet e mundshme. Në një takim me Drejtorinë e Planifikimit Hapësinor, grupi paraqiti iniciativën e vet, duke kërkuar përkrahje për të dhe udhëzime për procedurat zyrtare që duhet ndjekur për ta realizuar atë. Drejtori i kësaj drejtorie i ofroi grupit informatat e kërkuara dhe madje u pajtua që ta dërgojë ekspertin e drejtorisë për t'i dhënë grupit përkrahje në gjetjen e shtigjeve të mundshme për çiklizëm.

Me përkrahje nga Drejtoria e Planifikimit Hapësinor dhe eksperti i saj, grupi hartoi një projektpropozim politik që përmbante tri zgjidhje të mundshme për shtigje çiklizmi në komunën e Zveçanit. Pasi që mori miratimin e ministrisë për propozimin e vet, grupi caktoi takim me Kryetarin e Komunës së Zveçanit. Gjatë këtij takimi, grupi paraqiti të gjeturat dhe



propozimin e vet. Kryetari i Komunës u zotua se do të gjejë mjetet financiare për të krijuar së paku një nga tri shtigjet e propozuara në një të ardhme të afërt. Më pas, propozimi u miratua edhe nga autoritetet lokale dhe u inkorporua brenda planit urban të komunës.

“Duke qenë se haptas u përkrahëm nga kryetari i komunës, dhe duke parë se propozimi i grupit u pranua nga zyra e kryetarit të komunës dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, ne si entuziastë të sportit ndihemi tejte të inkurajuar dhe së shpejti do tu paraqesim atyre mundësi të reja. Ishte kënaqësi të jesh pjesë e Programit për Udhëheqësit e Rinj dhe pjesë e kësaj nisme. Shpresoj se do të kemi mundësi të ngjashme edhe në të ardhmen.” - Ines Alleviq.

Pjesëmarrësit: Ines Aljevic, Strahinja Jevtic, Vladimir Vuckovic




Integrimi i shtigjeve për biçikleta në planifikimin urbanistik



Drejtoria e komunës për Planifikim Hapësinor të marrë vendim për përfshirjen e shtegut të biçikletave në projektet infrastrukturore në të ardhmen



Sigurimi i mbështetjes online dhe avokim në komunat përkatëse




Prezentimi i propozimit në Drejtorinë për Planifikim Hapësinor



Propozimi i politikave është miratuar nga Drejtoria për Planifikim Hapësinor dhe Zyrës së Kryetarit

Ky publikim është mundësuar me mbështetjen e popullit zemërgjërë amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Qëndrimet e shprehura përmes kësaj platforme janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e USAID dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Të drejtat e autorit, Instituti Kombëtar Demokratik 2018. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pjesë të këtij punimi mund të përdoren dhe/ose të përkthehen për qëllime jofitimprurëse me kusht që NDI të njihet si burim i materialit dhe t'i sigurohet kopje e çdo përkthimi.



USAID
NGA POPULI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

